



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:217750  
Datë: 18.09.2024  
Numri i dokumentit: 06174621

**C.nr.2918/23.**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM** - Divizioni Civil, gjyqtari Migjen Kastrati, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.D, R.D të dy nga fshati N, Komuna e Pejës, të cilët i përfaqëson Adem Nikqi, avokat në Pejë, kundër të paditurit, M D dhe Komuna e Pejës, me bazën juridike vërtetim i pronësisë dhe dorëzimi i sajë, vlera e kontestit, 20.000 euro, jashtë seancës me datën 18.09.2024 gjykata bie:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET** propozimi i paditësit H.D R .D të dy nga fshati Nabergjan, Komuna e Pejës, për vazhdimin e procedurës së ndërprerë sipas aktvendimit me numër C.nr. 1983/04 i datës 14.09.2005.

**A r s y e t i m**

Fillimisht paditësit me datën 06.10.2004 kanë ushtruar padi kundër të paditurve me bazën juridike, vërtetim i pronësisë dhe dorëzimi i sajë, vlera e kontestit, 20.000 euro. Sipas aktvendimit të Gjykatës me numër C.nr. 1983/04 të datës 14.09.2005, është ndërprerë procedura në këtë çështja kontestimore për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake (*me arsyetimin si në aktvendim e marrë në procesverbalin e seancës së datës 14.09.2005*).

I autorizuari i paditësve parashtrësën e datës 13.09.2023 i është drejtuar gjykatës me kërkesën për vazhdimin e procedurës me arsyetimin se pala paditëse pasi që e ka kryer procedurën paraprakë të trashëgimisë, paraqet kërkesë për vazhdimin e procedurës së ndërprerë në lenë me numër C.nr. 1983/04, e duke bere edhe ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv.

Gjykata ka shqyrtuar dhe vlerësuar kërkesën e të autorizuarit të paditësve për vazhdimin e procedurës së ndërprerë sipas aktvendimit të lartcekur, ku tani për tani një propozim të tillë e ka refuzuar si në pikën **I** të dispozitivit të këtij aktvendimit me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdimin e procedurës, për të cilën është ndërprerë procedura sepse pala paditëse nuk ka bashkangjitur as një provë me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet për vazhdimin e procedurës së ndërprerë, respektivisht nuk ka dorëzuar në gjykatë provën për të argumentuar kërkesën për vazhdim, gjykata konstaton se nga momenti i ndërprerjes së procedurës kontestimore, nuk ka ndryshuar ndonjë nga rrethanat apo shkaqet për të cilat është ndërprerë kjo procedurë.

Me dispozitën e nenit, 13 të LPK-së, shprehimisht është përcaktuar se :’’ Kur vendimi i gjykatës varet nga zgjidhja paraprake e çështjes se a ekziston ndonjë e drejtë subjektive apo marrëdhënie juridike, e lidhur me të ende nuk ka marrë vendim, gjykata apo organi tjetër kompetent (çështja paraprake), atëherë gjykata ka tagër që vetë ta zgjidhë çështjen e tillë, në qoftë se me dispozita të veçanta nuk është caktuar ndryshe. Vendimi i gjykatës mbi çështjen paraprake ka efekt juridik vetëm në procedimin në të cilin është zgjidhur çështja e këtillë ’’. Me dispozitën e nenit, 278 të LPK- së, shprehimisht është përcaktuar se : ‘’Përveç rasteve të parashikuara me këtë ligj, gjykata e ndërpret gjykimin, po që se ka vendosur që vetë të mos e zgjidhë çështjen paraprake (neni 13 i këtij ligji) ‘’. Me dispozitën e nenit 280 pika 3 të LPK-së, shprehimisht është përcaktuar se : ‘’ Po që se gjykata e ka ndërprerë gjykimin nga shkaqet e përmendura në nenin 278 paragrafi 1 pika a) dhe paragrafi 2 të këtij ligji, gjykimi do të vazhdojë pasi të përfundojë procedura në formë të prerë tek gjykata apo organi tjetër kompetent, apo kur gjykata e çështjes konstaton se nuk ekzistojnë më arsyet për të pritur përfundimin e saj’’. Ndërsa me dispozitën e nenit 280 pika 4 të LPK- së, shprehimisht është përcaktuar se: ‘’ Në të gjitha rastet e tjera gjykimi i ndërprerë do të vazhdojë pasi të kenë pushuar shkaqet e ndërprerjes’’. ‘’

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, bazuar në nenin 280 par. 1 të LPK- së e lidhur me nenin 277 par.1 pika a) e lidhur me nenin 142.2 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2023:217750, C.nr. 2918/23 i dt. 18.09.2024**

**Gjyqtari**  
**Migjen Kastrati**

---

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.